



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 22
Prishtinë, më 22 tetor 2013, në orën 10:00, salla S-II
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Bali Muharremaj, Afrim Hoti dhe Albert Kinolli.

Munguan: Imri Ahmeti dhe Adem Grabovci.

I ftuar: Lars Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatorë e Komisionit, Mehmet Simnica zyrtar i fushës në Komision dhe Saranda Kelmendi, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 09.10.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të auditimit për vitin 2012;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 9.10.2013

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi njëzëri, pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 9 tetor 2013.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të auditimit për vitin 2012

Kryetari – Njoftoi të pranishmit se ky është vazhdim i mbledhjes së kaluar. Në mbledhjen e kaluar ka pasur paqartësi rreth rekomandimeve të ZAP-it. Kemi pasur disa takime me ZAP-in dhe tani kemi një tekst të përbashkët të rekomandimeve, të cilat propozoj të shkojnë në Kuvend si vijon: *Të miratohet Raporti vjetor i auditimit për vitin 2012. Qeveria e Republikës së Kosovës, të ndërmarrë masa për të zgjidhur mospajtueshmërinë midis sistemit E- pasuria dhe SIMFK-së. Qeveria e Republikës së Kosovës, me raport me shkrim, të njoftojë Kuvendin lidhur me trajtimin e borxheve, përfshirë këtu edhe informacionin për borxhet e parashkuara (kompanitë me emër dhe shuma të mjeteve). Qeveria e Republikës së Kosovës, në afatin prej 3 muajve, të hartojë strategji veprimi lidhur me trajtimin e borxheve të bartura nga viti në vit. Qeveria e Republikës së Kosovës të nxisë prokurimin elektronik, si dhe prokurimin publik të centralizuar, përmes Autoritetit Qendror të Prokurimit. Qeveria e Republikës së Kosovës, të bëjë plotësim-ndryshimin e Ligjit për vetëqeverisjen lokale, në përputhje me vërejtjet e Auditorit të Përgjithshëm. Ministria e Administratës Publike, në afatin prej 3 muajve, me raport me shkrim të njoftojë Kuvendin lidhur me procesin e rekrutimit, gradimit dhe stimulimit të të punësuarve për vitin 2012, të cilët kanë marrë pagë nga Buxheti i Kosovës. Obligohet Qeveria e Republikës së Kosovës, Kuvendi dhe institucionet e pavarura, që të zbatojnë projektin e GPS-it për përdorim të veturave zyrtare. Qeveria e Republikës së Kosovës, në afatin prej 1 muaji, me raport me shkrim, të njoftojë Kuvendin lidhur me përdorimin e Fondit të Kuadrove. Qeveria e Republikës së Kosovës, të mbikëqyrë performancën e ndërmarrjeve publike në lidhje me politikat e vendosura operative. Qeveria e Republikës së Kosovës, të bëjë plotësim-ndryshimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, për të qartësuar procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve. Agjencia Kosovare e Privatizimit, të ofrojë rregulla të qarta për mënyrën e administrimit dhe bashkëpunim të duhur në mes të menaxherëve të Trepçës, si dhe të kërkojë nga NSH “Trepça”, pasqyra vjetore financiare të unifikuara. Agjencia Kosovare e Privatizimit, të thjeshtësojë informatat financiare, për t'i bërë ato më të kuptueshme për lexuesit e jashtëm. Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Banka Qendrore e Kosovës, të hartojë strategji veprimi lidhur me mjetet e Fondit të Privatizimit. Ministria e Financave, të përkrahë organizatat buxhetore, me shtimin e numrit të auditorëve të certifikuar. Po ashtu, propozoi që këtë raport në mbledhje plenare ta prezantojë auditori i përgjithshëm.*

Ramiz Lladrovci – Pati vërejtje rreth organizimit të mbledhjes. Në radhë të parë, pasi që të shpërndahen ftesat për mbledhje të Komisionit, mbledhja mund të shtyhet vetëm me miratim të Komisionit. Në raste të tilla, mbledhjet mund të dështojë, por vullneti i mirë i yni ka bërë të jemi të pranishëm. Së dyti, në takimin e Prevallës, Komisioni është dakorduar se me cilat raporte do të merret dhe një gjë e tillë nuk është duke ndodhur. Ndërsa, sa i përket rekomandimeve të propozuara nga kryetari, nuk është se nuk do t'i përkrah, por si të tilla janë të përfshira në Raport të auditimit dhe për shumë pika janë të përcaktuara me ligj obligimet e Qeverisë për të raportuar, përkatësisht nëse i referohemi ligjit, Qeveria i raporton Kuvendit një herë në vit.

Valbona Dibra – Tha se të gjitha rekomandimet e propozuara nga kryetari, janë pjesë e raportit vjetor, dhe si të tilla (13 rekomandime), janë të tepërta. Në mbledhjen e kaluar, nuk është diskutuar përmbajtja e rekomandimeve, madje ato janë vlerësuar si shumë të sakta, por është diskutuar adresimi i tyre dhe gabimet eventuale teknike që kanë mundur të rrjedhin nga auditori i përgjithshëm. Por, edhe pse personalisht jam në hamendje lidhur me këto rekomandime, megjithatë do të përkrah vendimin Komisionit.

Lars Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm – Theksoi se është një progres shumë i mirë që vetë Komisioni ka formuluar rekomandimet bazuar në raportin e auditorit. Kjo është shumë e mirë. Pastaj, se cilat çështje i ka vlerësuar si më të rëndësishme, është diçka që i takon Komisionit. Megjithatë, mendoj që në këto rekomandime duhet të përfshihet edhe çështja e pasqyrave financiare të Fondit të Privatizimit, sepse me një pasqyrë të saktë, ju do të kishit informacionin se sa para kanë hyrë, sa para janë paguar, a janë paguar nga 20% etj. Kjo është shumë çështje kritike për Kosovën dhe një informacion që ju jepet partnerëve evropianë.

Kryetari –Lidhur me agjendën, tha se ka ndryshuar, pasi që në përrurimin e terminalit të aeroportit, i cili është planifikuar për ditën e mërkurë, do të marrin pjesë shumë deputetë, dhe si rezultat i kësaj, kam vlerësuar që do të jetë në rregull. Rekomandimet janë të bazuara në raport, por janë saktësuar, sepse në mbledhjen e fundit ka pasur pasaktësi. *P.sh. emërimi i kryeshefit ekzekutiv në komuna*, nuk mund të bëhet pa ndryshuar ligji. Kjo është arsyeja e këtyre rekomandimeve.

Lidhur me propozimin e auditorit, tha se në rekomandimin 10 dhe 11 është përfshirë çështja e privatizimit, megjithatë ishte i mendimit që të përfshihet edhe çështja e aseteve të shitura dhe likuidimi i ndërmarrjeve, si dhe përdorimi i 20%.

Ramiz Lladrovci – Rekomandimi i auditorit duhet përkrahur dhe kjo nuk e pengon asgjë rekomandimin e Komisionit.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri ka vendosur që Kuvendit t'i

REKOMANDOJË:

I. Të miratohet Raporti vjetor i auditimit për vitin 2012.

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, të ndërmarrë masa për të zgjidhur mos-pajtueshmërinë midis sistemit E- pasuria dhe SIMFK-së.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës, me raport me shkrim, të njoftojë Kuvendin lidhur me trajtimin e borxheve, përfshirë këtu edhe informacionin për borxhet e parashkruara (kompanitë me emër dhe shuma të mjeteve).
3. Qeveria e Republikës së Kosovës, në afatin prej 3 muajve, të hartojë strategji veprimi lidhur me trajtimin e borxheve të bartura nga viti në vit.
4. Qeveria e Republikës së Kosovës, të nxisë prokurimin elektronik, si dhe prokurimin publik të centralizuar, përmes Autoritetit Qendror të Prokurimit.
5. Qeveria e Republikës së Kosovës, të bëjë plotësim-ndryshimin e Ligjit për vetëqeverisjen lokale, në përputhje me vërejtjet e auditorit të përgjithshëm.
6. Ministria e Administratës Publike, në afatin prej 3 muajve, me raport me shkrim të njoftojë Kuvendin lidhur me procesin e rekrutimit, gradimit dhe stimulimit të të punësuarve për vitin 2012, të cilët kanë marrë pagë nga Buxheti i Kosovës.
7. Obligohet Qeveria e Republikës së Kosovës, Kuvendi dhe institucionet e pavarura, që të zbatojnë projektin e GPS-it për përdorim të veturave zyrtare.
8. Qeveria e Republikës së Kosovës, në afatin prej 1 muaji, me raport me shkrim, të njoftojë Kuvendin lidhur me përdorimin e Fondit të Kuadrove.

9. Qeveria e Republikës së Kosovës, të mbikëqyrë performancën e ndërmarrjeve publike në lidhje me politikat e vendosura operative.
10. Qeveria e Republikës së Kosovës, të bëjë plotësim-ndryshimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, për të qartësuar procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.
11. Agjencia Kosovare e Privatizimit, të ofrojë rregulla të qarta për mënyrën e administrimit dhe bashkëpunim të duhur në mes menaxherëve të Trepçës, si dhe të kërkojë nga NSH “Trepça”, pasqyra vjetore financiare të unifikuara.
12. Agjencia Kosovare e Privatizimit, të thjeshtësojë informatat financiare, për t'i bërë ato më të kuptueshme për lexuesit e jashtëm. Procesi i likuidimit të ndërmarrjeve dhe trajtimi i 20%.
13. Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Banka Qendrore e Kosovës, të hartojë strategji veprimi lidhur me mjetet e Fondit të Privatizimit.
14. Ministria e Financave, të përkrahë organizatat buxhetore, me shtimin e numrit të auditorëve të certifikuar.

II. Arsyetimin e Rekomandimit do ta paraqesë, deputeti Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

Në bazë të nenit 72, paragrafi 4 të Rregullores së Kuvendit, lidhur me shqyrtimin e Raportit vjetor të auditimit për vitin 2012, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, kërkon nga Kryesia e Kuvendit, që të ftojë auditorin e përgjithshëm, për të prezantuar në mbledhje plenare të Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 10:50.
E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu